# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 35

**Tiranë – E enjte, 12 mars 2015**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 10, datë 25.2.2015 | Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore dhe rajonale, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve | 1611 |
| Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 11, datë 25.2.2015 | Për shpërndarjen e fondit për arsimin, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve | 1613 |
| Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 12, datë 25.2.2015 | Për shpërndarjen e financimit për projektet në vazhdim për arsimin, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015 | 1615 |
| Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 13, datë 25.2.2015 | Për shpërndarjen e fondit për programin "Shqipëria dixhitale", thirrja e parë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve | 1619 |

**VENDIM**
**Nr. 10, datë 25.2.2015**

## PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE RAJONALE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të programit infrastruktura vendore dhe rajonale, transhi II, i thirrjes së I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, në vlerën 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore dhe rajonale, transhi II (THIRRJA 1)

| Nr. | Autoriteti kontraktues | Emërtimi i projektit | Vlera e plotë e projektit | Vlera e financimit për vitin 2015 | Vlera e financimit për vitin 2016 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | (lekë) | (lekë) | (lekë) |
| Qarku Dibër | | | | | |
| 1 | Bashkia Burrel | Rikonstruksion i fasadave dhe zëvendësimi i ndriçimit në rrugët: "Koke Malci"- Qendër- "Rexhep Pashë Mati", "Kuvendi i Dukagjinit" dhe trotuaret për rrugën "Kuvendi i Dukagjinit" | 66,508,393 | 46,555,875 | 19,952,518 |
| 2 | Bashkia Bulqizë | Pedonalja e qytetit dhe Unaza e Poshtme | 108,000,000 | 72,535,441 | 35,464,559 |
| Qarku Elbasan | | | | | |
| 3 | Bashkia Elbasan | Rikualifikim urban i parkut “Aqif Pasha” | 110,000,000 | 73,935,441 | 36,064,559 |
| Qarku Fier | | | | | |
| 4 | Bashkia Lushnje | Rikonstruksion i rrugës pedonale “Abaz Bej Lushnja” | 46,034,613 | 32,224,229 | 13,810,384 |
| Qarku Vlorë | | | | | |
| 5 | Bashkia Himarë | Shëtitorja buzë detit Qeparo, faza II | 190,000,000 | 99,812,535 | 90,187,465 |
| 6 | Bashkia Sarandë | Ndërtim asfaltim rr. nr. 5, loti II dhe III | 348,000,000 | 170,080,105 | 177,919,895 |
| 7 | Bashkia Sarandë | Rikonstruksion i Rrugës së Fermerëve, fshati Metoq | 52,000,000 | 26,000,000 | 26,000,000 |
| Qarku Korçë | | | | | |
| 8 | Bashkia Korçë | Zgjatim i bulevardit Republika, rikonstruksion dhe zgjerim i Rrugës Gjon Buzuku, sheshi tek xhamia, sheshi brenda pazarit | 100,000,000 | 70,000,000 | 30,000,000 |
| Qarku Berat | | | | | |
| 9 | Bashkia Berat | Rikualifikim dhe rikonstruksion i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale | 81,357,637 | 56,950,346 | 24,407,291 |
| 10 | Bashkia Berat | Rikonstruksion i bibliotekës "Vehxhi Buharaja" | 35,000,000 | 24,500,000 | 10,500,000 |
| 11 | Bashkia Kuçovë | Rikonstruksion i rrugës “Qemal Stafa” dhe “Kristaq Lacka” | 141,423,109 | 67,646,995 | 73,776,114 |
| Qarku Durrës | | | | | |
| 12 | Bashkia Durrës | Rrugë mbi kanalin kullues, K-192, Plazh, loti 1 | 100,218,968 | 67,088,718 | 33,130,250 |
| Qarku Shkodër | | | | | |
| 13 | Bashkia Shkodër | Rikualifikim urban i rrugicave në qendrën historike sheshi “Gjon Pali II-të” | 20,707,580 | 14,495,306 | 6,212,274 |
| Fondi Shqiptar i Zhvillimit* | | | | | |
| 14 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rivitalizimi i ndërtesave dhe shëtitorja e lumit në Tamarë | 63,015,374 | 44,110,762 | 18,904,612 |
| 15 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rikonstruksioni i Rrugës Adë (Karburanti) - Frakull e Vogël, Komuna Frakull | 82,273,041 | 57,591,129 | 24,681,912 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 16* | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rikonstruksioni i rrugës Levan - Shtyllas, Komuna Levan | 126,730,510 | 69,844,804 | 56,885,706 |
| 17 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Sistemim asfaltim i rrugës Tozhgez - Zhelizhan - Mazhaj, komuna Allkaj | 98,928,509 | 66,185,397 | 32,743,112 |
| 18 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Ndërtimi i shëtitores, KUZ, te liqeni i Farkës, Komuna Farkë | 90,765,048 | 63,535,534 | 27,229,514 |
| 19 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Peshtan, Komuna Qendër Tepelene | 25,254,944 | 17,678,461 | 7,576,483 |
| 20* | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rruga e fshatit Goranxi, Komuna Dropull i Sipërm | 57,288,131 | 40,101,692 | 17,186,439 |
| 21 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rehabilitimi i kryqëzimit të Shkozës, Bashkia Tiranë | 27,324,616 | 19,127,230 | 8,197,385 |
| TOTALI | | | 1,970,830,473 | 1,200,000,000 | 770,830,472 |

* Në zbatim të vendimit të KZHR nr.6, datë 9.2.2015, "Për administrimin "tranzitor" të projekteve me autoritet kontraktues komunat, për periudhën shkurt-shtator 2015".

Shënim

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i fondit për zhvillimin e rajoneve për vitin 2015.

3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

4. Për projektet e financuara më sipër (specifikisht projektet: 3, 8, 9, 10, 14) ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore".

5. Për projektet, me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën e plotë të projektit është përfshirë edhe vlera e supervizimit dhe kolaudimit të projektit.

6. Për projektin me nr. 5 (Shëtitorja Qeparo, faza II, me autoritet kontraktues Bashkinë Sarandë), autoriteti kontraktues duhet të marrë konfirmimin pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si edhe të dërgojë për miratim lejen përkatëse në KKT, përpara zbatimit të projektit.

## VENDIM
## Nr. 11, datë 25.2.2015

## PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të nënprogramit të arsimit (arsimi bazë dhe i mesëm), pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, në vlerën 420 500 000 (katërqind e njëzet milionë e peseëqind mijë) lekë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik për arsimin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas

kalendarit të paraqitur nga NQV-të, në përputhje në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, në nënprogramin e arsimit, nga FZHR 2015

| Nr | Autoriteti kontraktues | Emërtimi i projektit | Programi | Vlera e plotë e projektit (lekë) | Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë) | Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qarku Berat | | | | |
| 1 | Bashkia Ura Vajgurore | Rikonstruksion i kopshtit qendër Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore | 09120 | 26,705,933 | 13,352,967 | 13,352,967 |
| | | Qarku Durrës | | | | |
| 2 | Bashkia Durrës | Ndërtimi i shkollës "Jusuf Puka", Bashkia Durrës | 09120 | 144,382,317 | 65,188,031 | 79,194,287 |
| 3 | Bashkia Krujë | Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Skënderbej" Krujë, (sistem ngrohje dhe sistemim oborri) | 09230 | 25,696,275 | 12,848,138 | 12,848,138 |
| | | Qarku Elbasan | | | | |
| 4 | Bashkia Cërrik | Rikonstruksion dhe ndërtim palestre i shkollës 9-vjeçare "7 Marsi" bashkia Cërrik | 09120 | 51,517,643 | 25,758,822 | 25,758,822 |
| 5 | Bashkia Gramsh | Rikonstruksion i palestrës së gjimnazit "Shefqet Buzi", bashkia Gramsh | 09230 | 3,244,751 | 2,134,834 | 1,109,918 |
| | | Qarku Fier | | | | |
| 6 | Bashkia Fier | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Janaq Kilica", bashkia Fier | 09230 | 46,851,701 | 23,425,851 | 23,425,851 |
| 7 | Bashkia Divjakë | Rikonstruksion i kopshtit dhe palestrës në shkollën "Koli Sako", bashkia Divjakë | 09120 | 59,941,649 | 29,970,825 | 29,970,825 |
| 8 | Bashkia Divjakë | Ndërtimi i palestrës, terreneve sportive, rikualifikimi i hyrjes ana perëndimore, dhe muri rrethues i shkollës së mesme "Miti Zoi Saka " | 09120 | 67,144,140 | 33,572,070 | 33,572,070 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qarku Korçë | | | | | | |
| 9 | Bashkia Korçë | Shtesë shkolla 9-vjeçare "Stavri Themeli", Bashkia Korçë | 09120 | 49,999,496 | 24,999,748 | 24,999,748 |
| 10 | Bashkia Korçë | Terrenet sportive, shkolla "Qendër Komunitare" | 09120 | 10,973,517 | 5,999,217 | 4,974,301 |
| Qarku Lezhë | | | | | | |
| 12 | Bashkia Laç | Rikonstruksion i kopshtit nr. 1 në bashkinë Laç (dy kate) | 09120 | 40,607,035 | 20,303,518 | 20,303,518 |
| 13 | Bashkia Lezhë | Rikonstruksioni i sallës së Qendrës Kulturore Fëmijëve | 09120 | 9,575,174 | 5,300,044 | 4,275,130 |
| Qarku Shkodër | | | | | | |
| 14 | Bashkia Shkodër | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Xheladin Fishta" | 09120 | 22,468,458 | 11,234,229 | 11,234,229 |
| Qarku Tiranë | | | | | | |
| 15 | Bashkia Kavajë | Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr. 2, tek ish-rezervat e shtetit , Kavajë | 09120 | 23,165,934 | 11,582,967 | 11,582,967 |
| Qarku Vlorë | | | | | | |
| 16 | Bashkia Sarandë | Ndërtimi i një shkolle të re 9-vjeçare, Bashkia Sarandë (projekt i Bankës Botërore) | 09120 | 213,861,497 | 104,433,877 | 109,427,621 |
| 17 | Bashkia Vlorë | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Vlorë | 09120 | 60,789,733 | 30,394,867 | 30,394,867 |
| | | TOTALI | | 856,925,253 | 420,500,000 | 436,425,254 |

Shënim
1 . "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

**VENDIM**
**Nr. 12, datë 25.2.2015**

## PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTET NË VAZHDIM PËR ARSIMIN, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2014-2015, për nënprogramin e arsimit (arsimi bazë, arsimi i mesëm i përgjithshëm), në vlerën 978 393 443 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projektet, sipas pikës 1, me vendndodhje territorin e komunave, të cilat nuk kanë përfunduar punimet brenda qershorit 2015, në përputhje me vendimin nr. 6, datë 9.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, do të financohen përmes një marrëveshje delegimi, partneriteti rajonal dhe/ose partneriteti ndërkomunar me:

a) bashkinë qendër, e cila do të "përthithë", si njësi në ndarjen e re territoriale, komunën aplikuese, sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen

administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; dhe

b) këshillin e qarkut përkatës;

ku këto të fundit, si aplikant dhe autoritet kontraktues, do të zbatojnë projektin në emër dhe për llogari të komunës në territorin e të cilës shtrihet projekti.

3. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

Tabela 1. Projektet në vazhdim, në nënprogramin e arsimit, me cikël financimi 2014-2015

| **Nr.** | **Autoriteti Kontraktues** | **Emërtimi i projektit** | **Vlera e Kontratës (në Lekë)** | **Realizimi 2014** | **Vlera e Financimit për vitin 2015 (Lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Qarku Berat | | | |
| 1 | Bashkia Berat | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi 3 fushave sportive polifunksionale në ambientet e shkollave, me lote (shkolla "Ajet Xhindoli", lagjja Muzakaj prej 2,796,300L; shkolla "28 Nëntori", prej 2,976,300L; shkolla "Xhemal Cekini" prej 3,653,076L) | 7,424,000 | 4,684,440 | 2,739,560 |
| 2 | Bashkia Berat | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Thimi Tani" Bashkia Berat | 24,334,872 | 11,420,976 | 12,913,896 |
| 3 | Komuna Gjerbes | Rikonstruksion pjesor shkolla 9-vjeçare fshati Zaloshnjë, Komuna Gjerbes, Skrapar | 5,406,377 | 5,100,026 | 306,351 |
| 4 | Bashkia Berat | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Kristaq Capo" bashkia Berat | 26,225,240 | 11,996,160 | 14,259,080 |
| | | Qarku Dibër | | | |
| 5 | Komuna Gjoricë | Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe palestër Gjoricë, Komuna Gjoricë | 38,962,110 | 14,475,170 | 24,486,940 |
| 6 | Komuna Xibër | Shkolla e bashkuar Xibër, Komuna Xibër | 55,193,734 | 36,005,940 | 19,667,915 |
| 7 | Bashkia Peshkopi | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 terreneve sportive në shkolla të qytetit Peshkopi (shkolla "Nazmi Rrushti; shkolla "Demir Gashi"; shkolla "Seit Najdeni"; shkolla "Selim Alliu") | 31,174,406 | - | 31,174,406 |
| 8 | Komuna Kala e Dodës | Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe ndertim paleshër Radomire, Komuna Kala e Dodës | 38,042,570 | 32,971,639 | 5,070,931 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Qarku Durrës | | | | | |
| 9 | Bashkia Krujë | Rikonstruksion dhe shtesë anësore në shkollën 9-vjeçare nr. 4, Krujë, bashkia Krujë | 55,689,274 | 29,673,048 | 26,016,226 |
| 10 | Komuna Nikel | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ramazan Karaj", Nikel, komuna Nikel | 27,952,323 | 14,800,641 | 13,139,530 |
| 11 | Bashkia Fushë-Kruje | Ndërtim i shkollës së mesme "Shote Galica" Fushë-Krujë | 163,231,283 | 81,901,475 | 81,329,808 |
| Qarku Elbasan | | | | | |
| 12 | Bashkia Belsh | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, bashkia Belsh | 59,762,348 | 35,857,408 | 23,904,940 |
| 13 | Komuna Stëblevë | Ndërtim shkollë 1-katëshe, shkolla Fushë-Studenti, komuna Stëblevë, Librazhd | 16,668,000 | 8,450,744 | 8,217,256 |
| 14 | Bashkia Elbasan | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkolla të qytetit Elbasan (shkolla "Naim Frashëri" prej 8,352,548L; shkolla "Sul Harri" prej 8,143,603L; shkolla "Abdyl Paralloi" 8,233,578L; shkolla "Adem Krasniqi" prej 9,772,643L) | 32,376,545 | 22,348,542 | 10,028,003 |
| 15 | Komuna Rrajcë | Ndërtim shkolla CU Urake, komuna Rrajcë | 5,803,069 | 4,020,493 | 1,782,576 |
| 16 | Bashkia Elbasan | Përfundim i punimeve në shkollën "Xhafer Hakani", Elbasan | 11,987,760 | 6,000,000 | 5,987,760 |
| 17 | Komuna Kukur | Rikonstruksion shkolla e bashkuar "Muharrem Zela", komuna Kukur | 20,934,861 | 10,410,048 | 10,524,813 |
| Qarku Fier | | | | | |
| 18 | Komuna Portëz | Ndërtim kopshti, komuna Portëz | 7,706,580 | 3,132,192 | 4,574,388 |
| 19 | Bashkia Fier | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkolla të qytetit Fier, me lote (Shkolla "Jani Bakalli" prej 4,477,452L; Shkolla "Liri Gero" prej 5,323,962L; shkolla "Kristaq Gero" prej 5,323,962L; shkolla "Pinellopi Pirro" prej 5,323,962L) | 13,497,107 | 13,260,640 | 205,037 |
| 20 | Bashkia Fier | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Andon Xoxa" Fier | 33,315,328 | 17,313,228 | 16,002,100 |
| 21 | Bashkia Fier | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Jani Bakalli" Fier | 22,107,000 | 11,052,380 | 11,054,620 |
| 22 | Bashkia Patos | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Zhani Ciko", Patos | 42,966,761 | 15,735,233 | 27,231,528 |
| 23 | Bashkia Divjakë | Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Miti Zaka", Bashkia Divjakë | 17,657,328 | 6,019,560 | 11,637,768 |
| Qarku Gjirokastër | | | | | |
| 24 | Bashkia Gjirokastër | Terrene sportive në 4 shkolla (shkolla "Pandeli Sotiri"; shkolla "Thoma Papapano"; shkolla "Çajupi"; shkolla "Siri Shapllo", lagje Granicë) | 32,340,647 | 12,731,040 | 19,609,607 |
| 25 | Bashkia Gjirokastër | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Siri Shapllo", bashkia Gjirokastër | 33,045,881 | 18,163,567 | 14,882,314 |
| Qarku Korçë | | | | | |
| 26 | Bashkia Korçë | Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Mësonjëtorja e parë" | 53,644,475 | 49,992,268 | 3,652,207 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 27 | Bashkia Korçë | Terrene sportive në 4 shkolla të qytetit Korçë (shkolla "Demokracia"; shkolla "Naum Veqilharxhi"; shkolla "Sotir Gurra"; kompleksi shkollor rruga "Ajet Xhindoli") | 35,414,886 | 34,999,999 | 415,000 |
| 28 | Komuna Libonik | Ndërtim i shkollës cikli i ulët, fshati Poceste, komuna Libonik | 13,796,377 | 7,617,097 | 6,179,280 |
| 29 | Komuna Voskop | Rikonstruksion i shkollës së mesme Voskop sistem ngrohje, komuna Voskop | 35,880,360 | 17,340,630 | 18,539,730 |
| | | Qarku Kukës | | | |
| 30 | Komuna Arren | Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, Arren | 24,064,036 | 12,090,467 | 11,973,569 |
| 31 | Bashkia Kukës | Ndërtim i shtesës së shkollës 9-vjeçare "Bajram Curri", Kukës | 113,007,475 | 53,021,536 | 59,985,939 |
| 32 | Bashkia Kukës | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Mjedise sportive në 4 shkolla 9-vjeçare (Ndërtim palestre sportive e shkollës "Lidhja e Prizrenit" prej 10093120L; Shkolla " Bajram Curri" & Shkolla " Riza Spahiu" prej 8851437 L; Shkolla " Ahmet Voka",Gostil, prej 3647120L) | 22,591,677 | 14,494,654 | 8,097,023 |
| | | Qarku Lezhë | | | |
| 33 | Bashkia Lezhë | Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, bashkia Lezhë | 28,359,932 | 6,839,983 | 21,519,949 |
| 34 | Komuna Kaçinar | Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Kaçinar, Mirditë | 15,259,923 | 8,000,000 | 7,259,923 |
| 35 | Bashkia Lezhë | Ndërtimi i qendrës sportive tip, tek kompleksi i shkollave (2 qendra) | 20,518,380 | 13,336,947 | 7,181,433 |
| 36 | Komuna Blinisht | Rikonstruksioni i shkollës "Pjetër Zahrishi", Komuna Blinisht, Lezhë | 21,300,000 | 10,736,424 | 10,563,576 |
| | | Qarku Shkodër | | | |
| 37 | Komuna Bërdicë | Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare "Bërdicë e Madhe", Komuna Bërdicë | 19,914,678 | 9,993,900 | 9,920,778 |
| 38 | Bashkia Shkodër | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Mjedise sportive në 4 shkolla (shkolla "Dëshmoret e Prishtinës" prej 2,442,622L; Shkolla "Ndoc Mazi" prej 8,751,168L; shkolla "Ismail Qemali" prej 8.751.168L; shkolla "Branko Kadia" prej 9,751,168L) | 21,741,873 | 16,688,698 | 5,048,271 |
| 39 | Komuna Shale | Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare fshati Gimaj, Komuna Shale | 30,431,227 | 7,111,524 | 23,319,703 |
| 40 | Komuna Fierzë | Ndërtim i shkollës 9-vjeçare, fshati Mezi, Pukë | 28,626,278 | 14,513,391 | 14,112,887 |
| 41 | Komuna Gruemirë | Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Gruemirë, komuna Gruemirë | 22,195,654 | 10,601,502 | 11,594,152 |
| | | Qarku Tiranë | | | |
| 42 | Bashkia Tiranë | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Terrene sportive në 4 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maçi" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111) | 17,346,320 | - | 17,346,320 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 43 | Bashkia Tiranë | Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme "Qemal Stafa", njësia 10 | 152,297,454 | - | 152,297,454 |
| 44 | Bashkia Kavajë | Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr. 4 tek rruga "Sufajve" komuniteti i romëve Kavajë | 20,609,694 | 14,179,499 | 6,430,195 |
| 45 | Komuna Dajt | Shtesë kati i shkollës 9-vjeçare Qesarakë, Komuna Dajt | 46,699,592 | 23,349,741 | 23,349,851 |
| 46 | Komuna Vaqarr | Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të përgjithshme, Komuna Vaqarr | 26,000,000 | 7,587,961 | 18,412,039 |
| 47 | Komuna Ndroq | Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sadi Nuri", komuna Ndroq | 23,643,197 | 12,219,375 | 11,423,822 |
| | | Qarku Vlorë | | | |
| 48 | Komuna Novoselë | Ndërtim shkolla 9-vjeçare "Pilo Prifti", fshati Novoselë, komuna Novoselë | 47,497,121 | 28,498,254 | 18,998,867 |
| 49 | Bashkia Vlorë | Rikonstruksion kopshti nr. 10, Vlorë, bashkia Vlorë | 12,455,832 | 10,200,165 | 2,255,667 |
| 50 | Bashkia Vlorë | Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Terrene sportive për 4 shkolla 9-vjeçare (shkolla "Teli Ndini"; shkolla "4 Heronjte"; shkolla "Marigo Posio"; shkolla Ibrahim Kushta"; shkolla "Zigur Lelo"; shkolla " Rilindja") | 18,892,200 | 17,100,000 | 1,792,200 |
| 51 | Bashkia Sarandë | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë Sarandë | 38,242,451 | - | 38,242,451 |
| 52 | Bashkia Sarandë | Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane, Sarandë | 38,652,422 | - | 38,652,422 |
| 53 | Komuna Vranisht | Rikonstruksion shkolla e bashkuar Hore Vranisht, komuna Vranisht | 45,618,775 | 23,035,616 | 22,583,159 |
| 54 | Bashkia Vlorë | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Zigur Lelo" Vlore, bashkia Vlorë | 21,528,570 | 20,748,570 | 780,000 |
| 55 | Komuna Brataj | Shkolla e mesme e bashkuar "Hamdi Rrap Lazaj" Gjorm, komuna Brataj | 19,618,223 | 9,900,000 | 9,718,223 |
| | | Totali | 1,859,654,486 | 881,722,791 | 978,393,443 |

**VENDIM**
**Nr. 13, datë 25.2.2015**

## PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN "SHQIPËRIA DIXHITALE", THIRRJA E PARË, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të programit "Shqipëria Dixhitale", pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015, në vlerën 523 650 000 (pesëqind e njëzet e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, vendore, si edhe institucionet dhe organizatat për zhvillim, agjencitë zbatuese e zhvillimore qendrore e vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, në Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

Tabela 1. Projektet për financim për programin Shqipëria Dixhitale, FZHR 2015

| **Nr.** | **Autoriteti kontraktues** | **Emërtimi i projektit** | **Vlera e plotë e projektit (lekë)** | **Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)** | **Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit | Kontrata kuadër për shkrim projektesh në favor të zgjidhjeve smartcity për bashkitë. | 10,000,000 | 7,000,000 | 3,000,000 |
| 2 | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | Ngritja e regjistrit elektronik për personat me aftësi të kufizuar | 175,100,000 | 122,299,104 | 52,800,896 |
| 3 | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit | Platforma Qeveritare e Ndërveprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, Zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbime të reja në portalin qeveritar e-albania.al. Versioni 1.0 | 235,171,040 | 165,255,836 | 69,915,204 |
| 4 | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit | E-Ekzaminime (Sistemi i menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore) | 57,720,000 | 57,720,000 | - |
| 5 | Ministria e Punëve të Brendshme | Sigurimi i infrastrukturës teknike për menaxhimin qendror të provimeve dhe rekrutimeve për Departamentin e Administratës publike | 21,627,060 | 21,627,060 | - |
| 6 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore | Zgjerimi i shërbimeve të ISSH-së | 51,408,000 | 51,408,000 | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Ministria e Punëve të Brendshme | Përdorimi i platformës "Cloud" për rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike | 6,040,000 | 6,040,000 | - |
| 8 | Bashkia Korçë | Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit digjital | 89,000,000 | 62,300,000 | 26,700,000 |
| 9 | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit | Përmirëso qytetin | 30,000,000 | 30,000,000 | - |
| TOTALI | | | 676,066,100 | 523,650,000 | 152,416,100 |

Shënim

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.

3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

4. Për projektin me nr. 8 (Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit digjital), autoriteti kontraktues (bashkia Korçë) duhet të marrë konfirmimin nga Ministria e Punëve të Brendshme për standardet e përcaktuara në projekt, përpara fillimit të zbatimit të punimeve.

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 105 lekë